Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

# Procesverbal i takimit publik me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve në

# **Opterushë, Zoqisht, Retijë dhe Retijë e Ulët**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 802 Nr. i faq/Br str/No.pg 172
Data/Datum/Date 15/6/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

# INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e takimit publik me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve, u publikua me datë: 19.5.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz:

në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

*Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, kryetari i Komunës, Smajl Latifi organizon takime publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve në fshatra dhe vendbanime të komunës së Rahovecit.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së takimeve publike, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i takimeve publike për në vendbanimet e komunës së Rahovecit në këtë vegëz: Kalendari për organizimin e takimeve publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve, u publikua me datë: 18.5.2023 në të dy gjuhët, në këtë link: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/05/Kalendari-i-takimeve-me-qytetare.pdf

Poashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar me kohë banorët e secilit vendbanim rreth mbajtjes së takimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilën ditë të takimit, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber.

# TAKIMI PUBLIK NË OPTERUSHË, ZOQISHT, RETIJË DHE RETIJË E ULËT

Më datë: **9.06.2023** u mbajt takimi publik me qytetarët në fshatrat: Opterushë, Zoqisht, Retijë dhe Retijë e Ulët. Të pranishëm kanë qenë Kryetari i Komunës së Rahovecit, nënkryetari, disa drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal.

## *Opterushë*

Takimi filloi në ora **19:15**

Takimin e shpalli të hapur , znj.Besmire Bytyqi.

**Skender Krasniqi:** Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve, kryetar të falenderoj ty dhe stafin komunal për punën e palodhshme dhe për projektet e realizuara në fshatin Opterushë.Ju përgëzojmë për Zonën Industriale dhe ndriçimin i cili ka marr epilog.

Disa nga prioritetet që i kemi ne si fshat janë:

- Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit,
- Tensioni i lartë,
- Rrugë fushore,
- Të bëhët kubëzimi i rrugëve sepse kur ka reshje po bëhet bartja e zhavorrit.

**Eqrem Spahiu:** Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve!

- Hyrja e Zonës Ekonomike,
- Përrocka e fshatit-kyqja e dy përrenjve,
- Rrugë fushore që lidh 3 fshatra,,
- Kubëzimi i rrugëve,
- Kyqja e kanalizimit a ka mundësi në zonë ekonomike,
- Zëvendësimi i drunjve dekorativ.

## *Retijë dhe Retijë e Ulët*

**Ilir Kryeziu,** *përfaqësues i fshatit Retijë:* Ju përshëndes të gjithëve, i nderuar kryetar z.Smajl Latifi, drejtor dhe ju stafi komunal. Në bashkëpunim me kryesinë e fshatit i kemi këto kërkesa:

- Rregullimi i kanalit në mes fshatit,
- Rregullimi i shtratit të Lumit,
- Rregullimi i rrugëve dztësore me kubëza,
- 3 rrugë fushore të pakalueshme,
- Ndriçim publik,
- Kushtet e mjerueshme në shkollë,
- Ndërtimi i rrethojës së fushës së sportit,
- Bartja e nxënësve në shkollë.

**Mirsad Qehaja,** *përfaqësues i fshatit Retijë e Ulët:* Përshendetje për juve kryetar, drejtor dhe ju pjesëmarrës.

**Kërkesat që i ka në nevojë fshati Retijë të Ulët:**

- Mermetimi i objektit të shkollës,
- Parku në hyrje të fshatit,
- Mirëmbajtja e rrugës,
- Kubëzimi i disa rrugëve
- Ndriçmi publik nuk ka mirëmbajtje,
- Gropa septike,
- Trotuare në drejtim të shkollave,
- Pajisje me mjete konkretizimi,
- Rrugë fushore,
- Drunjt dekorativ 819 kanë dështuar.

**Avni Morina** ,*drejtor i Arsimit:* Ju përshëndes të gjithëve!

- Shkolla në Retijë është përuruar,
- Shkollat me numër të vogël të nxënësve sipas Ministrisë kanë kërkuar të ndahen në paralele, shkolla në Zoqisht dhe Retijë më shumë gjasë do të kalojë në kompetencë të Ministrisë.

**Erhan Morina** ,*drejtor i Ekonomisë:* Ju përshëndes të gjithëve!

- Zona Ekonomike ka filluar këtë vit, kemi marrëveshje mirëkuptimi.

**Smajl Latifi**,*kryetar i komunës:* Ju falenderoj të gjithëve, jemi sot këtu për të vazhduar procesin e takimeve publike.

Ndër projektet që janë zhvilluar dhe do të vazhdojnë, e disa edhe pritet të fillojnë së shpejti në vendet tuaj janë:

- Uji-nuk kemi kapacitet në mënyrë vetanake të investojmë.
- KRU-mirëmbajtja ekziston kur ka defekt, vështirësitë më të mëdha janë kur ka reshje,
- Ndriçimi publik-Komuna jonë e para për ndriçim digjital,
- Planet investive të KEDS-i kanë informacionet, detyrat.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!
Takimi përfundoi në ora 21:00

## *LISTA E NËNSHKRIMEVE*





## *FOTOGRAFI*







Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Rahovec, qershor 2023